



REPUBLIKA E SHQIPERISE  
Agjencia per Mbeshtetjen e Shoqerise Civile

Adresa: Rr. Frosina Plaku, Nr.58, ish Godina e Observatorit, kati II, Tiranë

Nr. 336 Prot.

Tiranë, më 2/12/2015

**URDHËR**

**“Për Delegimin e detyrave te Kordinatorit te Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit si dhe te Kordinatorit te riskut”**

Në mbështetje të Ligjit nr. 10 296, dt. 08/07/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”  
(I ndryshuar me Ligjin nr.110/2015, datë 15.10.2015”),

**URDHËROJ:**

1- Delegimin e detyrave të **Koordinatorit për Zbatimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit** tek Nëpunësi Zbatues i Institucionit, Znj.Leonida Hasa, duke kërkuar bashkëpunimin dhe angazhimin maksimal të gjithë stafit të AMSHC-së për përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me zbatimin dhe monitorimin e elementëve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në Institucion të tilla si: Mjedisi i Kontrollit, Aktivitete e Kontrollit, Informacioni dhe Komunikimi, Monitorimi.

2- Delegimin e detyrave të **Kordinatorit të Menaxhimit të Riskut** në Institucion tek Inspektori në Sektorin e Financës dhe Kontrollit të Brendshëm, Z.Alkent Shehaj i cili do të koordinojë dhe monitorojë procesin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Riskut me stafin e AMSHC- së, kryesisht në përpilimin e proceseve të punës, gjurmës së auditit për të gjitha proceset e punës në Institucion, përpilimin dhe përditësimin e Rregjistrit të Riskut si dhe Strategjisë së Riskut.

3- Të angazhohen të gjithë punonjësit për përpilimin e proçeseve të punës së tyre sipas detyrave dhe përgjegjësiqe që mbajnë bazuar në Rregulloren e Brendshme të Institucionit si dhe të bashkëpunojnë dhe koordinojnë punën e tyre me Kordinatorët e përcaktuar më lart, të cilët do të monitorojnë dhe raportojnë në afate kohore tre mujore për ecurinë e këtij proçesi në AMSHC.

4- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**ANDI KANANAJ**  
  
Drejtore Ekzekutive  
